

Në zbatim të ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe në cilësinë e gazetarit, kërkohet si vijon,

1. Sa është numri i “të sinjalizuarëve” në organizatën tuaj, gjatë pesë viteve të fundit (2018;2019; 2020; 2021; 2022) dhe në secilin prej viteve të mësipërme?
2. Cila është struktura e njësisë përgjegjëse (numri i anëtarëve të kësaj strukture; formimi, statusi dhe niveli përfaqësues administrativ i anëtarëve të saj) që regjistron, shqyrton dhe inspekton procedurat e hetimit administrativ të nisura për shkak të sinjalizimeve të marra nga sinjalizuesit, si dhe hetimet për mbrojtjen e sinjalizuesve, brenda autoritetit publik; mbi ç’kriteret është bërë përzgjedhja dhe funksionimi i njësive përgjegjëse?
3. Sa sinjalizime të brendshme janë regjistruar në organizatën tuaj, gjatë periudhës në fjalë?
4. A ka pasur rast kur anëtarët e njësive përgjegjëse kanë deklaruar se kanë qënë në kushtet e konfliktit të interesit, përpara fillimit të hetimit administrativ për shkak të një sinjalizimi? Nëse po, në ç’rrethana ka ndodhur; si është proceduar më tej, pas deklarimit?
5. Kopje e plotë e rregullores lidhur me zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit.
6. Sa është numri i hetimeve administrative të kryera pas marrjes së sinjalizimeve; numri inspektimeve të kryera nga njësia përgjegjëse në kuadrin e hetimeve administrative të filluara?
7. Sa prej hetimeve administrative të kryera në kuadrin e një sinjalizimeve kanë rezultuar në shkelje administrative?
8. Sa është numri i sinjalizimeve të cilat nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga legjislacioni (60/2016); ose nuk kanë pasur elemente të kundravajtjes administrative ose të veprës penale?
9. Sa është numri i sinjalizimeve të bazuara, të cilat i keni referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit?
10. Sa është numri i kërkesave për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje? A janë kryer hetime administrative ndaj këtyre pretendimeve?.
11. Kopje të raporteve vjetore të njësive përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.